

# Informacion mbi Cornwall



# Çfarë është Cornwall



Cornwall është një qark me shumë fshatra, plazhe dhe qytete të vogla. Kryeqyteti i Cornwall është Truro, i cili është një qytet i vogël.

Disa nga qytetet e tjera të njohura të Cornwall përfshijnë Newquay, St Austell, Penzance, Bodmin dhe Falmouth.

Cornwall është një vend shumë i njohur për turistët që vijnë me pushime. Shumë njerëz mendojnë se Cornwall është vend shumë miqësor. Ai është një vend i sigurt. Cornwall u kushton tepër rëndësi identitetit lokal dhe gjuhës së vet, pavarësisht se tani ajo nuk flitet gjerësisht.

## Një fëmijë nën kujdes



**CORNWALL**  
**COUNCIL**  
*one and all • onen hag oll*

- Në MB, ju klasifikoheni si fëmijë nëse jeni nën 18 vjeç. Nëse nuk keni prindër që të kujdesen për ju, përgjegjësia për këtë i takon autoritetit vendor.
- Tani që jeni në Cornwall, si fëmijë do të keni qasjen në arsim, kujdes shëndetësor, strehim dhe ndihmë financiare.
- Punonjësit në Ekipin 16+ dëshirojnë t'ju mbështesin për të ndërtuar një jetë të këndshme këtu me miq, hobi dhe një komunitet rreth jush.
- Ju duhet të jetoni në Cornwall derisa të mbushni 18 vjeç dhe derisa të merret një vendim lidhur me kërkesën tuaj për azil: atëherë do të jeni në gjendje të merrni vetë vendimin lidhur me vendin se ku dëshironi të jetoni brenda MB-së, vendim në të cilin ne do të bëjmë përpjekje maksimale për t'ju mbështetur.



# Kush ju mbështet

## **Punonjësi social:**

Punonjësi social është në dispozicionin tuaj për t'ju garantuar siguri, për t'ju mbështetur dhe për të përgatitur planin e rrugëtimit tuaj, i cili përfshin të gjitha detajet lidhur me mënyrën se si autoriteti vendor do t'ju mbështesë me akomodimin, nevojat shëndetësore, kërkesën për statusin e emigrantit, arsimimin, aktivitetet sociale dhe çfarëdolloj nevoje kulturore. Punonjësi social koordinon të gjithë personat që ju mbështesin për t'u siguruar që të gjithë të jenë duke bashkëpunuar. Punonjës social ju caktohet derisa të arrini moshën 18 vjeç.

## **Këshilluesi personal:**

Këshilluesi juaj personal do të punojë me ju deri në moshën 21 ose 25 vjeç, në varësi të rrethanave tuaja. Ai ju ndihmon të planifikoni të ardhmen dhe ju ofron këshillim, ndihmë dhe udhëzim. Ai duhet t'ju ndihmojë të përgatiteni për të ardhmen dhe të sigurohet që të keni mësuar të jeni i pavarur në momentin kur të jeni në moshë madhore.

## **Punonjësi mbështetës:**

Punonjësi mbështetës punësohet nga një organizatë bamirësie për të mbështetur fëmijët nën kujdes. Ai organizon aktivitete me fëmijë të tjerë që kërkojnë azil dhe me komunitetin e gjerë. Ai asiston punonjësit socialë dhe këshilluesit personalë për t'ju mbështetur, veçanërisht kur jeni i ri dhe ka shumë problematika që kërkojnë zgjidhje. Ai ju mbështet që të shfrytëzoni mundësitë që ju ofron Cornwall, për t'ju ndihmuar të ndërtoni një jetë në këtë vend. Ai është një person tek i cili mund të drejtoheni për çdo shqetësim apo problem.

# Kërkesa për azil

Pasi të mbërrini në Cornwall, me pëlqimin tuaj, punonjësi social do të organizojë një takim me një avokat imigracioni. Një avokat është dikush që do t'ju mbështesë dhe do t'ju përfaqësojë në kërkesën tuaj për azil.

Do të takoheni me avokatin tuaj, i cili do të plotësojë Formularin tuaj të paraqitjes së provave (SEF) lidhur me arsyen e aplikimit për statusin e refugjatit. Më pas do të merrni pjesë në një intervistë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila është përgjegjëse për vlerësimin e kërkesës suaj. Në intervistë do t'ju bëjnë çdo lloj pyetjeje që lidhet me SEF-në që keni dorëzuar. Do të vendoset në dispozicion një interpret për të garantuar që të jeni në gjendje të komunikoni pa asnjë problem.

# Të shqetësuar rreth kërkesës suaj për azil...

Procesi i kërkesës për azil, për fat të keq, kërkon një kohë të gjatë dhe ne nuk mundemi ta parashikojmë gjithmonë afatin kohor.

Ndërkohë, është e rëndësishme që të përpiqeni të mos shqetësoheni shumë rreth kësaj dhe të fokusohuni në jetën tuaj në Cornwall.

Të gjithë ata që punojnë me ju do të bëjnë përpjekje maksimale për t'ju mbështetur, duke përfshirë edhe avokatin i cili po punon që kërkesa juaj të kualifikohet.

Përpiquni gjithmonë të flisni me punonjësin social për çdo problem apo shqetësim që mund të keni rreth këtij procesi. Ju keni gjithashtu të drejtën të bëni kërkesë për një avokat të pavarur nga Departamenti për Fëmijët i Këshillit për Refugjatët.

# Shërbimet e emergjencës në MB

- Policia - Në MB policët janë persona të besuar të cilëve mund t'u drejtoheni për mbështetje në rast se keni ndonjë problem. Sidoqoftë, duhet të respektoni ligjet e MB-së ose përndryshe mund të arrestoheni. Ne do t'ju ndihmojmë të kuptoni ligjet në MB dhe do t'ju prezantojmë me oficerët e policisë lokale.
- Ambulanca/spitali - Në MB, nëse keni dhimbje apo lëndime të rënda mund të kërkonit një ambulancë për t'ju dërguar në spital duke telefonuar 999 në telefonin tuaj celular. Do t'ju kërkojnë emrin dhe vendndodhjen.
- Punonjësi social, këshilluesi personal dhe punonjësi mbështetës janë në dispozicion nga ora 8:45 deri në orën 17:15, nga e hëna në të premte. Për emergjencat gjatë orëve të mërkurës ose gjatë fundjavës ka në dispozicion një shërbim jashtë orarit.

Numri i shërbimit jashtë orarit është: 01208 251300



# Ligj i rëndësishëm i MB-së



- Në MB është e ndaluar të blini alkool dhe cigare derisa të keni arritur moshën 18 vjeç. Në shumicën e vendeve nuk lejohet duhani në ambiente mbyllura.
- Çështjet lidhur me racizmin mund t'i raportoni pranë çdo punonjësi ose në polici dhe problematika do të trajtohet me seriozitet.
- Në MB mosha e dhënies së pëlqimit për kryerjen e marrëdhënieve seksuale është 16 vjeç. Konsiderohet e paligjshme të kryeni marrëdhënie seksuale nëse jeni nën moshën 16 vjeç; të kryeni marrëdhënie seksuale me dikë që është nën moshën 16 vjeç, nëse ju jeni më i rritur; dhe të ndani ose të merrni imazhe me kontekst seksual të një personi nën moshën 18 vjeç. Gjithashtu kini parasysh se, edhe nëse të dy jeni mbi 16 vjeç, është e paligjshme të prekni dikë në mënyrë seksuale nëse nuk ju ka dhënë pëlqimin për këtë gjë.
- Nuk ju lejohet të drejtoni një mjet derisa të pajiseni me leje drejtimi dhe për këtë do t'ju duhet të kaloni një provë. Në MB mund të mësoni të drejtoni një mjet kur të keni mbushur 17 vjeç, sidoqoftë do t'ju duhet të aplikoni për një leje drejtimi provizore (është e mundur vetëm nëse keni leje qëndrimi).



# Shtëpia juaj

## **Kujdestaria:**

Nëse jeni nën 16 vjeç ose nëse jeni 16 vjeç dhe ende në shkollë, do të jetoni me një familje me persona madhorë të cilët do të jenë përgjegjës për t'u kujdesur për ju. Ata do t'ju sigurojnë ushqim dhe do t'ju ndihmojnë të sistemoheni në Cornwall.

## **Akomodimet e mbështetura:**

Nëse jeni mbi 16 vjeç mund të rrini në një familje me të paktën një person madhor, i cili ju mirëpret në shtëpinë e tij dhe do t'ju sigurojë një vakt në ditë. Ky person madhor do t'ju ndihmojë që të arrini të jeni i pavarur.

## **Banesat e periudhës së aftësisë:**

Këto ju lejojnë të keni më shumë pavarësi. Këtu jetoni vetëm, ndonjëherë me të rinj të tjerë nën kujdes të cilët jetojnë në të njëjtën ndërtesë dhe kanë prejardhje të ndryshme. Banesat do të kompletohen me pajisjet kryesore për t'ju siguruar komoditet.

\*Në Cornwall mundësitë për strehim janë të kufizuara, ndërkohë që kërkesa për sistemim është mjaft e lartë. Do të sistemoheni sipas mundësisë, por ne do të bëjmë më të mirë tonë për t'ju siguruar që të jetoni në vendin më të përshtatshëm\*



# Ne do t'ju ofrojmë mbështetje lidhur me...

## SHËNDETIN:

- Sapo të mbërrini do t'u nënshtroheni menjëherë analizave shëndetësore. Me pëlqimin tuaj, mjeku do t'ju bëjë disa analiza për një kontroll të përgjithshëm të gjendjes suaj shëndetësore.
- Gjithashtu do të referoheni për një ekzaminim për tuberkuloz
- Do të regjistroheni te një mjek lokal (Mjek i Përgjithshëm).
- Do të shtoheni në listën e pritjes te dentisti ose do t'ju ofrohet ndihmë për të marrë trajtim dentar në raste urgjente.
- Do të keni mundësinë të kontrolloheni nga një mjek i syve.
- Mund t'ju referojmë te Brook ku mund t'ju ofrohet mbështetje lidhur me shëndetin seksual, nëse dëshironi të flisni me dikë rreth kësaj çështjeje [www.sexualhealthcornwall.co.uk](http://www.sexualhealthcornwall.co.uk)
- Ne do t'ju mbështesim për t'u regjistruar në palestër, nëse keni dëshirë dhe/ose për të konsideruar çdo aktivitet tjetër.



# ...gjithashtu do t'ju ofrojmë mbështetje lidhur


me



## ARSIMIMIN:

- Në MB arsimi i detyrueshëm është deri në moshën 18 vjeç.
- Do t'ju mbështesim të studioni gjuhën angleze për folësit e gjuhëve të tjera, nëse keni nevojë.
- Në universitet, në moshën 17-19 vjeç, mund t'i zgjidhni vetë lëndët kur të keni arritur të zotëroni mjaftueshëm gjuhën angleze. Në shkollën e mesme, në moshën 11-16 vjeç, nxënësit mësojnë një sërë lëndësh.
- Do të pajiseni me një abone autobusi që do t'ju çojë dhe do t'ju marrë nga

# Paratë në dispozicion



- Shuma e parave që do t'ju vihet në dispozicion varet nga vendi ku jeni sistemuar dhe nga shuma që ju nevojitet.
- Gjatë kohës që do të jeni nën kujdestari ju do të merrni para xhepi dhe prindërit tuaj kujdestarë do të sigurohen që t'ju plotësojnë, aq sa është e domosdoshme, çdo nevojë tjetër.
- Nëse jetoni në akomodimet e mbështetura ose në një banesë të periudhës së aftësisimit, do të merrni një shumë parash javore personale e cila do të përdoret për ushqim, veshmbathje, artikuj të kujdesit personal dhe artikuj të tjerë të domosdoshëm.
- Nëse keni një mik ose anëtar të familjes që dëshironi ta vizitoni, mund të na bëni një kërkesë. Në kryejmë kontrolle që të sigurohemi se nuk ka asnjë rrezik dhe më pas biem dakord për pagesën e udhëtimit tuaj për t'i vizituar: por vetëm gjatë periudhës së pushimeve të universitetit.